

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Klodiana e Shëndetësisë anulon tenderin 50 milionë € të dializës
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/25/klodiana-e-shendetesise-anullon-tenderin-50-milione-e-te-dializes/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:13:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:10:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	75122e2103e6e56427afdb19ca8ee697620a9858775178b5bd3a2cbfa2f3892a
TEKSTI	ad6458c823f3c35667e2ce2834738646e298a10a87e7670b189050e5e9ee2541
PAMJA	8c5a1dfe820d717587e7e5169f01e518931fa359eaf9062bc2cbdf4c1bb7b089

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	53782a201f5a0ebc30ff6ed1c01d2bec9ad2e37a6304c3974dcac363a28cf11f
E MËPARSHMJA	a0ffc336a6fb4141c6ab119157c46a680db2ccabb2b81e8bd124a3d05a138f29
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/53782a201f5a0ebc30ff6ed1c01d2bec9ad2e37a6304c3974dcac363a28cf11f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Klodiana e Shëndetësisë anulon tenderin 50 milionë € të dializës

13:10 : 25/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE



Lufta për ndarjen e plaçkës tek Shëndetësia ka kulmuar me një vendim të paprecedentë. Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore ka anuluar zyrtarisht tenderin 50 milionë euro për shërbimin e dializës gjatë katër viteve të ardhshme, edhe pse kishte shpallur fitues të kësaj procedure suedezeit e Diaverum.

Sipas dokumentave të depozituara në Agjencinë e Prokurimeve Publike, arsyeja e anulimit të tenderit ka qenë sepe dokumentat e tij përmbajnë gabime të rëndësishme.

Objekti i tenderit :	Ofrimi i shërbimit të hemodializës në 5 (pesë) qendra të hemodializës, të ngritura në spitalet Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan, Marrëveshje Kuadër 48 muaj
Autoriteti kontraktues :	Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore Sh.A
Fituesi :	
Rezultati :	0.00 Lekë
NIPT :	
Procedura :	E hapur, mbi kufirin e lartë monetar
Tipi i kontratës :	Shërbime
Numri i referencës :	REF-96313-08-14-2026
Numri i Njofimit :	CN/62226/09102026
Fondi limit :	4,591,430,480.00 Lekë
Data e publikimit :	11-09-2026 Ora : 13:58
Data e hapjes :	17-08-2026 Ora : 08:00
Data e mbylljes :	01-09-2026 Ora : 13:00
Arsyeja e anulimit :	konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme

TË GJITHA



Tiranë/ Parandalohet shërri me sende të forta mes të miturve, procedohen 23 persona

13:39 : 25/09/2026



Korreshi denoncon djegien e mbetjeve në Krutje: Po helmohen njerëzit!

13:23 : 25/09/2026



Klodiana e Shëndetësisë anulon tenderin 50 milionë € të dializës

13:10 : 25/09/2026



"Bleona është gjallë!"/ Gjyshi rrëfen misterin e zhdukjes: Dy gra të dyshimta me shami u panë në fshat...

13:06 : 25/09/2026



"Territorialja"/ Banorët e Patosit letër Kuvendit: Kërkojmë ruajtjen e bashkisë si njësi më vete

12:58 : 25/09/2026



Çfarë strategjie mund ta ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?

12:42 : 25/09/2026



Gysi, Bela, Lali, Klod Zoto si maska të një njeriu të vetëm

12:27 : 25/09/2026

Pezulluar : Jo

Kodi CPV : 85111900-9 - Shërbime dializash spitalore,

Anullimi i një tenderi kaq të madh pas shpalljes së fituesit është një vendim shumë i pazakontë. Por cilat janë arsyet se pse Klodiana Spahiu e anulloi tenderin e majmë? Gjithçka lidhet me luftën e ashpër për të shtënë në dorë llokat e buxhetit të shëndetësisë.

Tenderi

Lexo edhe:

[PD kërkon dorëheqjen e ministres së Shëndetësisë: Klodiana Spahiu të sqarojë dyshimet për plagjiaturë](#)

["Ministrja kopjace" në krye të Shëndetësisë? Diploma e Klodiana Spahiut përballlet me akuza për plagjiaturë](#)

Tenderi për shërbimin katërvjeçar të dializës u finalizua në 11 shtator. Ish drejtoresha e Operatorit, Arisa Cane, e shpalli fituesin vetëm pak minuta pasi Klodiana Spahiu kishte marrë zyrtarisht detyrën e ministres së Shëndetësisë duke zëvendësuar Evis Salën.

Por sapo mori vesh se Cane kishte shpallur fituesin e tenderit, Klodiana Spahiu firmosi menjëherë shkarkimin e saj nga posti i drejtoreshës së Operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësore duke e zëvendësuar me Yllka Shetan. Arsyeja se pse Spahiu e shkarkoi Canen ishte pikërisht shpallja e fituesit të tenderit 50 milionë euro.

Arisa Cane ishte njeriu i Evis Salës. Ajo e shpalli fituesin e dializës pa miratimin e Klodiana Spahiut, e cila dyshon se Cane ja dha kontratën e majme njerëzve të lidhur me Salën. Për këtë arsye, Spahiu ka urdhëruar drejtoreshën e re të Operatorit që të anullopë tenderin, ndonëse mbetet ende e paqartë se cilat janë gabimet e rëndësishme, me të cilat Sheta ka argumentuar anulimin e tenderit.

Yllka Sheta është akuzuar publikisht nga opozita si kushëriri e bashkëshortes së kryeministrit Edi Rama. 'Pas kontrollit familjar të AKSHI-t përmes kunatit të Linda Ramës, tani një tjetër familjarë vendoset në krye të një institucioni që administron dhe prokuron shërbime me vlerë qindra milionë euro', denoncoi deputeti i Partisë Demokratike, Bardh Spahia menjëherë pas emërimit të Shetas në krye të OSHISH.

Lufta për plaçkën ekspozon buxhetin

Anullimi i një tenderi pasi është shpallur zyrtarisht fituesi i tij është një lëvizje e rrezikshme, që e ekspozon buxhetin e shtetit përballë kërkesave për kompesime të mëdha dëmsh. Nuk dihet nëse kompania suedeze Diaverum do të ankimojë vendimin në KPP dhe më pas në rrugë gjyqësore për të kërkuar kompesim.

Edhe pse kontrata për këtë tender nuk u firmos, sërish risqet për buxhetin janë të mëdha. Operatori i Shërbimeve të Integruara duhet të argumentojë dhe të bindë gjykatën që arsyet për anulimin e tenderit ishin legjitime dhe ky nuk ishte thjesht një vendim për t'ia hequr tenderin një kompanie që ishte përzgjedhur si fituese nga njerëzit e Evis Salës.

Kjo nuk do të jetë e lehtë. Risku më i madh në gjithë këtë përplasje klanesh të pushtetit për të ndarë plaçkën e buxhetit, është që kompania e shpallur fituese mund të marrë kompesim të majmë.

Në këtë rast qytetarët do të paguanin dy herë nga xhepi. Një herë për kompesimin e Diaverum, të cilës ja hoqën tenderin pasi e shpallën fituese dhe një herë tjetër për fituesin e ri që do të përzgjedhë Klodiana Spahiu. **/Kapitali.al**

Etiketa: dializa Klodiana Spahiu tender

Lajme të lidhura



PD kërkon dorëheqjen e ministres së Shëndetësisë:



"Ministrja kopjace" në krye të Shëndetësisë? Diploma e



Skandal në tenderin e KQZ: Sekretarja ndërhyri në sistem

Klodiana Spahiu të sqarojë dyshimet për plagjiaturë

11:32 : 23/09/2026



3 ministre dhe premtimi i pambajtur për PET Scan-in

18:28 : 17/09/2026

Klodiana Spahiut përballat me akuza për plagjiaturë

21:50 : 18/09/2026



Ministrat e Ramës me "sëmundje" të pashërueshme

17:31 : 17/09/2026

për të favorizuar kompaninë e vëllait të Ferit Hoxhës

12:02 : 18/09/2026



Berisha-Spahiut: U betove për të mbrojtur aktet korruptive në shëndetësi, jep dorëheqjen sa më parë

14:12 : 17/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtj është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.